



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2024:078719

Datë: 03.01.2025

Numri i dokumentit: 06677005

P.nr.52/2024

### NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA NË KLINË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Sabrije Rraci, me pjesëmarrjen e Bashkëpunëtores Profesionale Fatmire Elezaj, në çështjen penale kundër të pandehurit S G nga fshati C K.K, për shkak të veprës penale Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar i armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamentit të Përgjithshëm PP-II.nr.249/2024 të datës 06.03.2024, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me dt.02.12.2024, në të cilin ishin të pranishëm Prokurorit të Shtetit Ramiz Buzhala dhe i pandehuri S G dhe mbrojtësi i tij ex officio av.Njomza Hoxha nga Peja, me dt.02.12.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 03.01.2025, e përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

I pandehuri S G nga i ati Xh G e ëma Xh G e gjinisë D, i lindur me datë , në fshatin C K.K ku dhe tani banon, me nr.personal: ka të kryer shkollën fillore, punëtor fizik, i gjendjes së dobët ekonomike, baba i fëmijve, i gjendjes së dobët ekonomike, shfrytëzues i skemës sociale, i nacionalitetit Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

### ËSHTË FAJTOR

SEPSE :

me parë dhe gjerë me datë 02.02.2024 në shtëpin e tij në fshatin C K. Klinë, në kundërshtim me nenin 5 par.1 të Ligjit për Armë (Ligji nr.05/L-022 ) ka mbajtur në

pronësi kontroll një armë zjarri, në atë mënyrë që ditën kritike gjatë kontrollit dhe bastisjes që është bërë në lokalitetin „R,, në K, nga policia përkatësisht nga stacioni policor në klinë, gjatë realizimit të planit operativ „kontrollimi i lokaleve të natës, tek i pandehuri është gjetur dhe sekuestruar një (1) pistoletë M-57 IT , kalibër 7.62 mm , me numër serik 26025.

me çka ka kryer veprë penale, Mbajtja në pronësi kontroll ose posedimi i paautorizuar i armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 69,70 dhe nenit 366 par. 1 të KPRK-së, si dhe nenit 241, 242, 364, 449 dhe 463 të KPPRK-së:

## GJYKON

### DËNIM ME KUSHT

I.Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej dy (2) vite, nuk kryen veprë të re penale.

II. Dënimi me kusht do t'i revokohet nëse i pandehuri kryen veprë penale brenda periudhës verifikuese prej 1 (një) viti, konform nenit 50 të KPRK-së.

III. Lirohet: i pandehuri nga shpenzimet e procedurës penale për shkak të gjendjes së dobët ekonomike .

IV.Urdhërohet Konfiskimi dhe shkatërrimi i armës së sekuestruar dhe atë një pistolet M-57 TT kalibër 7.62 mm me nr.serik 26025 dhe shtatë fishekë kalibër 7x25 mm.

### A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzë PP-II.nr.249/2024 e datës 06.03.2024, kundër të pandehurit S Gnga fshati C K.K, për shkak të veprave penale, Mbajtja në pronësi, kontroll posedim i paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 i KPRK-së.

Gjykata me datë 02.12.2024, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën kanë prezantuar Prokurori i Shtetit, Ramiz Buzhala i pandehuri S G si dhe mbrojtësja i tij ex officio av.Njomza Hoxha nga Peja.

Në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me dt.02.12.2024, ku pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit në kuptim të nenit 241 të KPPK-së, gjyqtarja e vetme gjykuese pasi bindet se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ofron mundësinë e deklarimit rreth fajësisë, ashtu që i pandehuri S G pas konsultimit paraprak të mbrojtësen e tij, i pandehuri ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale që i vihej në barrë, më vie keq për këtë që kam bërë, dhe i njëjti deklaron se shpreh pendesë për veprën penale të kryer, premtan se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera apo të ngjashme penale, këtë armë e kam të trashëguar nga lufta.

Mbrojtësja e të pandehurit av.Njomza Hoxha nga Peja ka deklaruar se; pajtohem në tërësi me pranimin e fajësisë të mbrojturit tim, meqë e njëjta është bërë me vullnet të plotë, pa presion nga askush dhe pas konsultimit të mjaftushem me mua si mbrojtëse dhe meqë i mbrojturi im i ka kuptuar benefitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë.Po ashtu deklaroj se i propozoj gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit si rrethana lehtësuese të marrë pranimin e fajësisë, fakti se i njëjti që nga fillimi i kësaj procedure ka bashkëpunuar me organet e drejtësisë i njëjti është i moshës së re, i gjendjes së dobët ekonomike dhe mbajtës i familjes, po ashtu i njëjti siq ka deklaruar më parë jeton në një vend të largët në afërsi të pyllit dhe qëllimi i vetëm për të cilën ka mbajtur armën ka qenë mbrojtja nga rreziqet që i kanoset në vendbanimin e tij

Deklarimi i palëve lidhur me pranimin e fajësisë

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e tij, pasi që ka vlerësuar se një pranim i tillë është në përputhje me nenin 242 par.2 të KPPK-së, pranimi i fajësisë është i vullnetshëm, i bazuar në provat materiale si në aktakuzë dhe i ka propozuar gjykatës që pranimin e fajësisë ta merre si rrethanë lehtësuese, ndërsa sa i përket rrethanave rënduese i ka propozuar gjykatës që të merr parasysh intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur si dhe shkallën e përgjegjësisë penale.

Poashtu edhe mbrojtësja e tij av. Njomza Hoxha, pajtohet me pranimin e fajsisë i cili pranim fajësie është bërë me vullnetin e tij dhe pa presion nga askush. Mbrojtësja kërkon që si rrethanë lehtësuese gjykata të merr faktin që jeton në një vend të largët në afërsi të pyllit dhe qëllimi i vetëm për të cilën ka mbajtur armën ka qenë mbrojtja nga rreziqet që i kanoset në vendbanimin e tij si dhe moshën e re të pandehurit.

Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë.

Në shqyrtimin fillestar, gjyqtarja e vetme gjykuese pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri, nga se ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtarja e vetme gjykuese ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i njëjti, se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale, të cilat mbështesin aktakuzën siq janë: Shënim zyrtar i përpiluar nga hetuesi policor D T me dt.03.02.2024, Raporti i oficerit policor E B i përpiluar me dt.02.02.2024, Raporti i oficerit policor R G i përpiluar me dt.03.02.2024, deklarata e të dyshuarit të dhënë në polici me dt.02.02.2024, Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i dt.02.02.2024, lista e armëve të konfiskuara të dt.04.02.2024, procesverbal për kontroll dhe sekuestrim të përkohshëm, kërkesë për sekuestrim, urdhër për bastisje dhe kontroll i dt.01.02.2024, urdheres për lëshimin e urdherit ndalues përfundimtar ndaj masës së përkohshme, mbajtja e pasurisë në dhomën e dëshmitarëve i dt.08.02.2024, fotografit e armës së sekuestruar si dhe shkresat e tjera të lëndës.

Gjendja faktike e vërtetuar:

Bazuar në të lartëcekurat gjyqtari i vetëm gjykuës ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se i pandehuri me dashje ka kryer veprën penale, Mbajtja në pronësi, kontroll të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Në nenin 366 par.1 të KPRK-së është përcaktuar se formën themelore të veprës penale e kryen,, Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në kundërshtim me

ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesë qind (7.500 ) euro ose me burgim deri në pesë (5 ) vjet ”.

Andaj bazuar në të lartëcekura, gjykata ka vendosur që të pandehurin ta shpall fajtor për kryerjen e veprës penale,, Mbjajtja në pronësi, kontroll ose posedimi i paautorizuar i armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, nga se veprimet e të njëjtit përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtat është penalisht përgjegjës.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësin e dënimit.

Lidhur me llojin dhe lartësin e dënimit, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit bazuar në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së duke e vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Si rrethanë lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, premtimin e të njëjtit se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra penale, si rrethanë tjetër lehtësuese gjykata muar moshën relativisht të re si dhe që i njëjti është kryefamiljar dhe mbajtës i vetëm i familjes i cili është prind i 6 fëmijëve, të moshës së mitur, si dhe pendimin e tij për kryerjen e veprës penale, ndërsa si rrethana rënduese sa i përket të pandehurit gjykata ka gjetur intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur si dhe shkallën e përgjegjësis penale.

I pandehuri i ka dorëzuar gjykatës dëshminë se është shfrytëzues i skemës sociale i lëshuar në emër të bashkëshortes së tij H G, dëshmia e lëshuar nga QPS Klinë me dt. 03.12.2024 me nr. të regjistrit 58232.

Gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të njëjtit nga kryerje e veprave tjera penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit

Konfiskimin dhe shkatërrimin e armës nga gjykata është bazuar në nenin 366 par.3 ku është përcaktuar se,, arma në pronësi, kontroll apo posedim në kundërshtim të këtij neni konfiskohet dhe të shkatërrohet.

Vendimi mbi lirimin nga shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 452 par.4 të KPPK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në arsyet e lartëcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA KLINË

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

P.nr.52/2024 me datë 03.01.2025

Gjyqtarja  
Sabrije Rraci

Bashkëpunëtorja profesionale  
Fatmire Elezaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejte te parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.